



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 67 Prot

Gjirokastrë, më 18.12.2019

V E N D I M

Nr. 03 , datë 18.12.2019

P Ë R

MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË F.E.


Mbështetur në ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 43 pika 3 dhe në Statutin e Universitetit "E.Çabej" neni 20 pika 5, Dekanati i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e tij të datës 18.12.2019:

V E N D O S I

1. Të miratojë Planin Strategjik të Zhvillimit të F.E (bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/ DEKAN

Dr. Robert ÇELO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI EKONOMIK

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË FAKULTETIT EKONOMIK

PËR PERIUDHËN
2020 - 2025



PËRMBAJTA

1. HYRJE	3
2. NJË HISTORIK I SHKURTËR.....	4
3. MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE	5
4. RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA	7
5. MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT	8
6. KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE	10
7. LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE.....	15
8. ANALIZA SWOT.....	16



1. HYRJE

Suksesi e transformimit të arsimit sipas modeleve të sotme më të përparuara e garanton zhvillimi dhe institucionalizimi i politikave arsimore, modelet bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Masat për transformimin e sistemit arsimor kanë synuar ristrukturimin dhe modernizimin edhe të Arsimit të Lartë.

Në këtë kuadër edhe Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit “Eqrem Çabej” ka bërë përpjekje për t’ju bashkëngjitur këtyre zhvillimeve, duke qenë i hapur kundrejt ideve të reja bashkëkohore, hartimit dhe zbatimit të programeve të përparuara për zhvillimin e shoqërisë, duke nxitur ambiciet profesionale dhe angazhimet e mirëfillta pedagogjike e shkencore.

Përfshirja në procesin e Bolonjes ka bërë që Fakulteti Ekonomik të reflektojë e përsosi ndryshime në strukture dhe përmbajtje. Staf i akademik po bëhet gjithnjë e më i kualifikuar dhe është rritur ndjeshëm bashkëpunimi i Fakultetit Ekonomik me partnere brenda e jashtë vendit.

Hartimi, menaxhimi dhe zbatimi i këtij Plani – Strategjik i Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik do të jete kyçi i zhvillimit të suksesshëm të fakultetit tonë dhe do të ndihmojë për një integrim me të mirë të fakultetit me komunitetin dhe nevojat që ai ka në vitet në vijim..

Programi afatgjatë/mesëm për zhvillimin e Fakulteti Ekonomik është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit të lartë në Evropë dhe në bote, dhe në veçanti me procesin e Bolonjes. Ky program afatgjatë/mesëm për zhvillimin e fakultetit tonë do të jetë në sinkron me Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit, duke marrë parasysh edhe sugjerimet e stafit akademik dhe të grupeve studentore të interesuara për zhvillimin e këtij fakulteti.



2. NJË HISTORIK I SHKURTËR

Përgatitja e ekonomistëve në Gjirokastrë e ka filluesën e saj në vitin 1968 kur në këtë qytet u cel filiali i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës. Dega e ekonomikut funksionoi për disa vite, duke i shërbyer kryesisht përgatitjes së ekonomistëve për rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Përmet e Tepelenë. Eksperienca e fituar, prania në rreth e specialistëve si dhe nevojat gjithnjë në rritje që diktonte ekonomia e tregut për ekonomistët bëri që në vitin 1996 të hapet pranë universitetit “Eqrem Çabej” dega “Kontabilitet financë” me VKM nr. 631 datë 23.09.1996 “Një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 332 datë 13.05.1996 “Për pranimet në shkollat e larta në vitin shkollor 1996-1997”.

Departamenti Ekonomik i çelur po në vitin 1996, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, fillimisht u ofronte studentëve programin 4-vjecar në Kontabilitet-Finance të cilët në fund të studimeve fitonin diplomë me titull “Kontabilist”. Në vitin akademik 2001-2002 mbi bazën e shkresës së MASH Nr.2551 Prot., Datë 21.06.2001, me lëndë “Miratim për hapjen e kursit të studimit”, u hap një degë e re me profil “Ekonomist për Administrim Publik” dhe në vitin 2005 hapet dega e Turizmit.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në RSH, I ndryshuar” filloi puna për reformimin e kurrikulave sipas Kartës së Bolonjës dhe ristrukturimin e Departamentit Ekonomik për të ofruar dy cikle studimi.

Në vitin akademik 2017 - 2018 u hap njësi kryesore “Fakulteti Ekonomik” me 3 departamentet përkatëse: Departamenti Kontabilitet Finance, Departamenti i Administrimit Publik dhe Departamenti Politikave Ekonomike dhe Turizmit, bazuar në Urdhrin nr. 126 dt 20.03.2017. Aktualisht Fakulteti Ekonomik ka 3 njësi bazë dhe 9 programe studimi.

Fakulteti Ekonomik është i organizuar si më poshtë:

1. Njësia bazë e Kontabilitet Financës
2. Njësia bazë e Administrimit Publik
3. Njësia bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit

Fakulteti Ekonomik ka diplomuar me qindra studente në të dy format e studimit, të cilët shërbejnë në fusha të ndryshme si në sektorin privat ashtu edhe në atë shtetëror, duke dhënë kështu një kontribut të vyer në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në veprimtarinë mësimore e shkencore të



Fakulteti Ekonomik japin kontributin e tyre rreth 20 pedagoge te brendshëm, 2 pedagoge te ftuar dhe 9 pedagoge te jashtem. Pjesa dërrmuese e stafit akademik kane kryer studime, trajnime e specializime jashtë shtetit, fale edhe lidhjeve te shumta qe Fakulteti Ekonomik ka krijuar me partnerë në vendet e tjera.

Pedagoget e FE kane qene e janë pjesëmarrës aktive ne konferenca, sesione shkencore e ne botime te ndryshme brenda e jashtë vendit.

FE ka pasur dhe vazhdon te ketë lidhje dhe bashkëpunim me te gjitha universitetet e tjera te vendit si dhe lidhje të shumta dhe bashkëpunime me universitetet e vendeve të tjera si: Janinë, dhe Selanik në Greqi, Molisse, në Itali, në disa universitete të Spanjës (Universiteti IES LAGO Madrid dhe Konsortiumi i Shkollave të Larta Ekonomike Spanjë), Silezisë në Poloni, Turku në Finlandë, etj.

Mbi bazen e pervojës dhe arritjeve te deritashme fakulteti ka kryer studime që kane lidhje me zhvillimin perspektiv te tij, e drejtim te zgjerimit me programe te reja studimi. Gjithashtu synohet rritja e bashkëpunimeve në kuadër të Erasmus Plus për mobilitetet e studenteve dhe stafit akademik duke fituar përvoja e praktika të reja në procesin mësimor.

3. MISIONI, VIZIONI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Misioni

Misioni i FE-së përqendrohet në krijimin e kapaciteteve reale për shoqërinë nëpërmjet përgatitjes së specialistëve në fushën e financës dhe kontabilitetit, administrimit publik dhe turizmit.

Ky mision është i përqendruar në përgatitjen e specialistëve të lartë të ekonomisë dhe në përgatitjen e specialistëve të nivelit më të ulët nëpërmjet programit 2 - vjeçar me karakter profesional. Gjithashtu, ky fakultet synon të shërbejë edhe si një qendër e rëndësishme kërkimore-shkencore në rajon.

Vizioni

FE synon të përshtatet e t'i paraprijë zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit. Ai synon të kthehet në një qendër të edukimit të vazhdueshëm për Rajonin e Jugut. FE do të vazhdojë të jetë qendër e fuqishme për arsimimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës, nga reformat social-ekonomike dhe nga standardet e reja të integritimit evropian.

Prioritetet Strategjike



Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor do të jenë objektivi kryesor në FE, duke u përpjekur që t'i paraprijë dinamikës së ndryshimeve dhe nevojave të së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë së vendit tonë. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- Zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore me synim përmirësimin e rritjen e kulturës së cilësisë;
- Zgjerimit të shërbimeve në kuadër të zhvillimit të UGJ;
- Rritjes në mënyrë graduale të nivelit të punës shkencore dhe bashkëpunimit me universitet e institucionet partnere;
- Orientimit të veprimtarisë së FE për zhvillimin e rajonit të Gjirokastrës;
- Edukimit të studentëve të një mendimi krijues, të lirë, të pavarur dhe qytetar aktiv.

Të gjitha të dhënat dhe vlerësimet gjatë këtyre viteve të tranzicionit e kanë renditur papunësinë si një ndër problemet kryesore të shqiptarëve. Si rrjedhim, qeveria shqiptare me të drejtë e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe Direktivat e Bashkimit Europian, Strategjisë Evropiane të Punësimit 2020 si dhe kërkesave për integrimin europian të Shqipërisë.

Në këtë aspekt njësitë bazë pranë FE-së janë përpjekur që krahas programeve ekzistuese dhe me traditë në sistemin tonë arsimor të bëjnë edhe riorganizime dhe hapje të programeve të reja. Konkretisht gjatë vitit të kaluar, në përshtatje me legjislacionin në fuqi, u riorganizuan dhe filluan me program te ri programet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe u 3 programe 2-vjeçare me karakter profesional.

Nisur edhe nga fakti se arsimi i lartë profesional është ajo shkallë e nivelit arsimor, e cila kombinon shkathtësitë praktike me kurrikula teorike dhe përgatit studentët për tregun e punës, nga analiza e tregut të punës u pa e arsyeshme dhe u realizua hapja e programeve studimore, me karakter profesional “Ndihmës ekonomist” “Asistent Administrativ” dhe “Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike”. Hapja e këtyre programeve profesionale u motivua në radhë të parë nga dëshira për t'u ofruar gjithë maturantëve një mundësi më shumë për të studiuar në një fushë të arsimit profesional. Si dhe një mundësi konkrete që afron tregu i punës. Programet studimore, me karakter profesional synojnë t'u përgjigjen këtyre sfidave të shoqërisë që janë edhe prioritet për qeverinë shqiptare me qëllim nxitjen e punësimit si kolona kryesore e sistemit të mirëqenies sociale.

4. RISTRUKTURIMI I PROGRAMEVE EKZISTUESE TË STUDIMIT DHE HAPJE PROGRAMESH TË REJA

A. Ristrukturimi i programeve ekzistuese të studimit

- Ristrukturimi kaloi përmes një procesi të vështirë për shkak të koncepteve të reja që futeshin në organizimin e tërë veprimtarisë mësimore, por edhe për shkak të moskuptimeve apo kundërshtimeve.
- Ky është një proces që do të vazhdojë edhe me tej, sepse ristrukturimi i programeve të studimit do të bëhet edhe për vitet e tjera të studimit.
- Sot ne vitin akademik 2019-2020 FE ka 3 njësi bazë, konkretisht njësi bazë e Kontabilitet Financës, njësi bazë e Administrimit Publik dhe njësi bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit

B. Hapja e programeve të reja të studimit dhe rritja e numrit të studenteve

Zgjerimi i FE me programe të reja studimi është një objektivi i rëndësishëm.

1. Arritje e rëndësishme e FE-se, është ristrukturimi dhe çelja e programeve të studimit si me poshtë:

Sot ne vitin akademik 2019-2020 FE ka 3 njësi bazë dhe këto programe studimi:

FAKULTETI EKONOMIK			
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR"			
Nr	Emërtimi i Programit	Cikli i studimit	Forma e studimit
1.	"Bachelor" në Kontabilitet Financë	Cikli i parë	Kohë e plotë
2.	"Bachelor" në Administrim Publik	Cikli i parë	Kohë e plotë
3.	"Bachelor" në Turizëm	Cikli i parë	Kohë e plotë
PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL"			
1.	"Master Profesional" në Kontabilitet -Financë	Cikli i dytë	Kohë e plotë
2.	"Master Profesional" në Administrim Publik	Cikli i dytë	Kohë e plotë
3.	"Master Profesional" në Turizëm	Cikli i dytë	Kohë e plotë
PROGRAME 2 - VJEÇARE ME KARAKTER PROFESIONAL			
1.	Program profesional në Ndhmës Ekonomist	Program profesional	Kohë e plotë
2.	Program profesional në Asistent Administrativ	Program profesional	Kohë e plotë
3.	Program profesional në Asistent – Menaxher në Shërbimet Turistike	Program profesional	Kohë e plotë

Në të ardhmen do të punohet për hapjen e masterit shkencor në:

- Kontabilitet Finance (Departamenti i Kontabilitet - Financës)

Në kuadër të programeve të formimit të vazhduar do të punohet për t'u hapur këto kurse:

- a. Kurs 6 mujor për kompjuterizimin e kontabilitetit sipas teknologjive të reja (*Departamenti i Kontabilitet Financës në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës*).
- b. Kurs 3 mujor me punonjësit e pushtetit vendor për problemet e administrimit publik (*Departamenti i Administrimit Publik*).
- c. Kurs 3 mujor për trajnimin e agjencive turistike (*Departamenti Politikave Ekonomike dhe Turizmit*)

5. MËSIMDHENIA DHE TË NXËNIT

Objektivat:

Procesi mësimor kërkon që në kuadrin e përmirësimit të cilësisë së të mësuarit të punohet në drejtim të:

1. Modernizimit të metodave dhe teknologjive të mësimdhënies, duke synuar në metodat ndërvepruese dhe të përqendruara tek studentet që zhvillojnë tek këta të fundit ato shprehje të kompetencave që u duhen atyre për të ardhmen.
2. Përditësimit dhe pasurimit të përmbajtjes së programeve mësimore dhe ligjëratave me të dhëna të reja bashkëkohore të shkencës.
3. Pajisjes së të diplomuarve me shprehje të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato të analizës, të të menduarit, të arsytimit, paraqitjes dhe komunikimit.
4. Përmirësimit të kurrikulave në mënyrë të vazhdueshme për t'i bërë ato sa më fleksibile në raport me detyrat që shtron koha për specialiste të tanë.
5. Rritjes së pjesëmarrjes së studenteve në punën kërkimore-shkencore dhe në bashkëpunimin mes tyre dhe pedagogëve.
6. Përmirësimit të cilësisë së praktikave profesionale dhe atyre në terren.

Veprimet qe do te ndërmerren:

1. Evidentimi i përmbajtjes se vjetruar te mësimdhënies nga çdo departament dhe mbi këtë bazë programimi dhe realizimi i trajnimit te nevojshëm te personelit akademik.
2. Kualifikime jashtë shtetit, sidomos shkëmbime afatshkurtra të personelit akademik me universitete të huaja me të cilat kemi marrëdhënie bashkëpunimi, sidomos me universitetet perëndimore, si një mënyre efikase për të zhvilluar shprehinë mësimdhënëse të pedagogëve tanë.
3. Organizimi i shkëmbimit dhe përhapjes të përvojës se fituar për metodat e mësimdhënies të pedagogëve që kryejnë kualifikimin pedagogjik e shkencor jashtë shtetit.
4. Fitimi i gradave e titujve akademik nga anëtarët e departamenteve
5. Kompletimi cilësor i personelit akademik te nevojshëm.

Kufizimet qe duhen përballuar:

1. Mungesa e pajisjeve te përshtatshme për një mësimdhënie moderne.
2. Mungesat e fondeve e lehtësive për lëvizjen e lire te personelit akademik per te kontaktuar, konsultuar e krijuar bashkëpunimin e nevojshëm, shkëmbyer eksperiencë e përvoja me homologët përkatës neper bote.
3. Mungesa e specialisteve te ngushte brenda fushave përkatëse si dhe e literaturës specifike ne këto nivele.
4. Mungesa e mjediseve te pranueshme te punes per stafin akademik e shkencor (mjedise, pajisje,etj.), gjë për te cilën se fundi po jepen zgjidhje.
5. Plan-botimet shume te kufizuara e te vogla.
6. Kufizimet financiare për kryerjen me rentabilitetin e duhur te praktikës profesionale apo asaj ne terren.

Përballimi i këtyre kufizimeve:

1. Te rriten përpjekjet e personelit akademik per përmirësimin dhe pasurimin e bazës materiale qe varet nga forcat tona.
2. Rritja e cilësisë se punës nga ana e personelit akademik.

Matja e arritjeve:

1. Me % e personelit akademik te përfshire ne veprimtari zhvillimi për te përmirësuar stilin dhe metodat e mësimdhënies.
2. Me numrin e personelit akademik te trajnuar për te zhvilluar shprehitë e mësimdhënies.
3. Me % e rritjes se cilësisë se procesit te te nxënit e kërkimit nen dritën e ndryshimeve te reja.
4. Me % e masës se kurrikulave te mbuluara e ilustruara nga baza materiale e didaktike.
5. Me numrin e individëve qe fitojnë grada dhe tituj akademik.
6. Me sasinë e botimit te teksteve, artikujve, monografive, etj.. nga personeli akademik.
7. Me nivelin cilësor te përgatitjes se studenteve ne fushat përkatëse.
8. Me % e pjesëmarrjes se studenteve ne kërkimin shkencor.
9. Me numrin e studenteve te pranuar dhe numrin e atyre qe diplomohen
10. Përputhja e te diplomuarve me nevojat e tregut te punës dhe me politikat e punësimit

6. KËRKIMI DHE STUDIMET SHKENCORE

Strategjia e FE për kërkimin shkencor

Aktiviteti në kuadrin kërkimor shkencor në FE, zhvillohet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (Kreu VIII, Neni 93 “Kërkimi Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë”).

FE kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese.

Nëpërmjet kësaj strategjie, FE synon të jetë një *qendër ekspertize dhe ekselence* në fushën e studimeve ekonomike. Gjithashtu, FE synon:

- të përcaktojë prioritetet e kërkimit shkencor referuar përcaktimit të objektivave të veprimtarisë kërkimore të çdo anëtari të stafit akademik, duke synuar përputhjen e objektivave të kualifikimit shkencor individual me objektivat kërkimore-shkencore të njësisë bazë, njësisë kryesore, nevojave të zhvillimit rajonal;
- të rrisë standardin e kërkimit duke promovuar standardet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore;
- të orientojë kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë që i përgjigjet zhvillimit social-ekonomik të rajonit;



- standardizimin e “profilit të pedagogut” në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015, akteve nënligjore në zbatim të tyre;
- përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor e konsideruar si mundësi “e artë” për të realizuar objektivat të kërkimit shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe orientimin e tyre në tregun e punës;
- zgjerimin e partneritetit me çdo institucion që nga organizatat lokale partnerë strategjike, partnerë institucionalë, partnerë sipërmarrës etj, që mund të ndihmojnë në përmbushjen e misionit të tij, duke e konsideruar partneritetin si çelësin e suksesit;
- të përfshihet në sa më shumë projekte zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve europiane të arsimit të lartë, projekte që mbi të gjitha targetojnë zhvillimin e stafit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, aplikimin e standardeve europiane të cilësisë, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, përkthime e botime akademike e pedagogjike nga autorë të njohur ndërkombëtarisht, pajisjen e mjediseve mësimore dhe laboratoreve, etj.
- Këto synime, FE përpiqet t’i realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Jetëzimi i Strategjisë 2020 - 2025 përbën një ndër synimet më të rëndësishme të fakultetit tonë.

Për të vënë në jetë vizionin e tij studimor-kërkimor, FE ka hartuar plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, në përputhje me strategjinë e universitetit për kërkimin shkencor, prioritetet e MASR në fushën e kërkimit shkencor si dhe prioritetet e rajonit për zhvillim.

Strategjia e FE për kërkimin shkencor parashtrohet:

- të realizojë vlerësimin e veprimtarisë kërkimore – shkencore të njësisë bazë.

Kërkimi akademik në FE ka si qëllim:

- prodhimin dhe organizimin e dijes, zhvillimin e teorive të reja si dhe promovimin, forcimin e veprimtarive kërkimore në shërbim të mjedisit akademik, të bazuara në metodologji të reja e të mirëfillta shkencore;
- zhvillimin dhe inovacionin pedagogjik, i cili ka të bëjë me futjen dhe përdorimin e metodologjive pedagogjike, mjeteve të edukimit dhe materialeve e teknikave mësimore innovative;
- orientoje kërkimin drejt praktikës e cila do të prodhojë dije të reja duke kontribuar në përparimin e efektshëm të praktikës së menaxhimit. Kjo kategori mbështetet në metodologji të bazuara në vëzhgime nga afër dhe të thelluara të situatave komplekse të biznesit, rasteve studimore, anketimeve etj;

Politikat e kërkimit shkencor

Fakulteti Ekonomik krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpiqet të realizojë më sukses dhe **kërkimin shkencor** nëpërmjet metodave bashkëkohore.

Aktiviteti kërkimor - shkencor në FE bazohet, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur në politikat mbi arsimin e lartë të ndjekura nga MASR dhe UGJ, i orientuar nga reformat social – ekonomike, nga tregu i punës si dhe nga standartet e reja të integritit evropian.

Kërkimi shkencor, si tërësia e veprimtarive që krijojnë dije, përbën një të drejtë të personelit akademik që ushtrohet në kushtet e lirisë akademike, e cila garanton pavarësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

FE nëpërmjet njësive bazë kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, sipas natyrës dhe objektivave specifike të institucionit.

Në veprimtarinë mësimore-shkencore të FE japin ndihmesën e tyre rreth 21 pedagogë të brendshëm. Rreth 80.0% e personelit akademik kanë fituar tituj e grada shkencore dhe pjesa tjetër vazhdon punën për kualifikim. Në FE një pjesë e mirë e pedagogëve kanë kryer studime, kualifikime e specializime jashtë shtetit, falë lidhjeve të shumta dhe bashkëpunimit që FE ka krijuar me Universitetet e vendeve të tjera si: Janinë, dhe Selanik në Greqi, Molisse, në Itali, në disa universitete të Spanjës (Universiteti IES LAGO Madrid dhe Konsortiumi i Shkollave të Larta Ekonomike Spanjë), Silezisë në Poloni, Turku në Finlandë, etj.

Pedagogët e FE kanë qenë dhe janë pjesëmarrës aktiv në projekte të ndryshme, në konferenca e sesione shkencore, në botime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, etj.

FE është angazhuar tërësisht në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tij

a. Objektivat:

1. Të vendosë veprimtarinë kërkimore shkencore të fakultetit në funksion të:
 - a. rritjes së cilësisë së procesit të mësimdhënies, mësuarit gjatë gjithë jetës,
 - b. zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor duke e konsideruar këtë si domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar;
3. Të vazhdojë me ritme të shpejta kualifikimin e stafit akademik pa gradë.

4. Të përfshijë më gjerë stafin akademik dhe studentorë në projektet kërkimore-shkencore, kombëtare e ndërkombëtare;
5. Të inkurajojë dhe krijojë një gjenerate të re kërkuesish shkencorë në fushat ekonomike;
6. Të vendosë kërkimin në funksion të komunitetit, mjedisit e shoqërisë në tërësi;
7. Të rrisë cilësinë dhe numrin të botimeve të përgatitura nga anëtarët e Njësive Bazë (artikuj, monografi, tekste mësimore etj, si dhe cilësisë së tyre;
8. Të zgjerojë dhe forcojë marrëdhëniet e partneritetit me institucionet vendore, bankat, bizneset e qarkut, institucione kërkimore-shkencore etj.
9. Hartimin e një kalendarit vjetor të aktiviteteve shkencore-kulturore (konferenca kombëtare e ndërkombëtare, seminare, simpoziume, lektorime, leksione të hapura, referime shkencore, workshope etj;
10. Të sjellë sa më afër botën akademike me komunitetin dhe biznesin, duke ofruar konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, dhe ekonominë e bazuar në dije.

Strukturat përgjegjëse për Kërkimin Shkencor

Sipas Ligjit dhe Statutit të UGJ, kërkimi kryhet nga njësitet bazë koordinuar nga zyrat e Njësive Kryesore. Njësitet bazë hartojnë plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, në përputhje me strategjinë e universitetit për kërkimin shkencor, prioritetet e MASR në fushën e kërkimit shkencor, prioritetet e rajonit për zhvillim, të cilat depozitohen pranë Dekanit të Fakultetit. Pra stafi akademik i FE-së kryen punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë njësive bazë (si kërkues shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektsh kërkimore).

Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;

Kërkimi shkencor në FE bëhet nga njësitet bazë dhe mund të jetë:

- a. Kërkim shkencor bazë pa përdorim të menjëhershëm praktik;
- b. Kërkim shkencor i aplikuar në lidhje të ngushtë me nevojat dhe interesin publik.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në funksion të mësimdhënies, si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të njësive bazë dhe FE J është përqendruar në këto drejtime:

- a. Hartimin e planeve dhe programeve të reja mësimore: U realizua hapja e programeve studimore, me karakter profesional “Ndihmës ekonomist” “Asistent Administrativ”, “Asistent Menaxher në Shërbimet Turistike”.



- b. Ristrukturimi i planeve dhe programeve ekzistuese: u bë një punë serioze, duke angazhuar të gjithë stafin akademik të njësive bazë, për përmirësimin dhe rristurimin e planeve dhe programeve ekzistuese mësimore si dhe dokumentacionit të nevojshëm për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe të ciklit të dytë “Master Profesional”
- c. Zhvillimin e kurikulave, planeve mësimore, cikleve të ligjëratave, konform udhëzimeve dhe ligjit të arsimit të lartë.
- d. Pjesëmarrjen në veprimtari jashtë universitare të lidhura jo vetëm me performancën arsimore.
- e. Forcimin e punës kërkimore-shkencore të stafit, me qëllim arritjen e objektivave të kualifikimit shkencor.
- f. Përdorimin e metodave dhe teknologjive më të reja në mësimdhënie.
- g. Hartimin dhe përgatitjen e teksteve universitare dhe dispencave mësimore.

Për mbarëvajtjen më të mirë të procesit mësimor, pajisjes së studentëve me njohuri bashkëkohore, shprehi e kompetenca të domosdoshme për të ardhmen e tyre, duhet:

- vëmendje më e madhe për përfshirjen e studentëve në aktivitete specifike të projekteve.
- bashkëveprim më efektiv me biznesin dhe komunitetin përveç dy misionëve të tjera të FE (mësimdhënies dhe kërkimit) për të siguruar një sistem efektiv veprimi.

Produktet në fushën e kërkimit shkencor

Veprimtaria kërkimore-shkencore si një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit të stafit të FE është përqëndruar në këto drejtime:

1. Aktiviteti Kualifikues.
 - a. Vazhdimi i punës kërkimore-shkencore.
 - b. Vazhdim i punës kualifikuese për grada e titujt, etj.
2. Aktiviteti Botues: Artikuj, recenca shkencore për periodikë kombëtarë / ndërkombëtarë.
3. Referime dhe pjesëmarrje në Konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Udhëheqje e temave të diplomës në Master profesional.
5. Pjesëmarrje në projekte, etj.

7. LIDHJET KOMUNITARE DHE KOMBËTARE

FE krahas misionit të tij të parë, atë të edukimit, përpiqet të realizojë më sukses edhe dy misionet e tjera, kërkimin shkencor dhe atë të bashkëpunimit me sektorët publik e privat të rajonit përmes edukimit të vazhdueshëm dhe angazhimit social. Rritja e rolit të FE në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, mund të realizohet me përmbushjen e këtyre objektivave:

1. Duke ofruar krahas mësimi edhe veprimtari të ndryshme praktike si konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera, duke përftuar në këtë mënyrë të ardhura shtesë. Klientët potencialë për këto shërbime do të jenë komunitetet dhe bizneset lokale, organet e qeverisjes vendore e qendrore si dhe organizata të ndryshme donatore.
2. Duke krijuar lidhje të forta me komunitetin lokal dhe duke treguar vëmendje të veçantë ndaj nevojave të këtij komuniteti.
3. Duke bashkëpunuar efektivisht me Prefekturën, Qarkun, Bashkitë, drejtoritë dhe agjencitë e ndryshme rajonale, OJF-të e ndryshme etj. në funksion të reflektimit të punës së departamentit në interes të komunitetit.
4. Duke siguruar bashkëpunime për të zgjidhur një sërë problemesh të rajonit që e shqetësojnë.
5. Duke shërbyer si qendër e kualifikimit të ekonomistëve, sipërmarrësve etj, të rajonit.
6. Duke inkurajuar partneritetin dhe integrimin e të rinjve në komunitet për gjetjen e alternativave që do të mundësojnë kohezionin social dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

b- Veprimet që do të ndërmerren:

1. Organizimi i work-shopeve me komunitetin (sipas tematikave e rastit).
2. Organizimi i konferencave të shtypit dhe tryezave të rrumbullakëta.
3. Ngritja e një komiteti rajonal të politikave të zhvillimit me intelektualët e njohur të rajonit.
4. Trajnime në funksion të sektorit privat në rajon dhe tregut të punës.
5. Hartimi dhe zbatimi i projekteve dhe studimeve të përbashkëta.
6. Nxitja dhe krijimi i një aleance të suksesshme midis aktorëve kryesorë në rajon.
7. Afrimi i komunitetit të biznesit me botën akademike, duke ofruar konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije.

8. ANALIZA SWOT

PIKAT E FORTA

1. Kualifikimi i kënaqshëm shkencor e pedagogjik i stafit tone akademik.
2. Arritjet e deritashme nga stafi akademik si ne fushën akademike dhe ne atë shkencore.(studime, botime, projekte, etj.)
3. Ekzistenca e një sërë lidhjesh dhe raportesh pune me homologët tanë brenda dhe jashtë vendit.

PIKAT E DOBËTA

1. Mungesa e kontingjentit cilësor në pranimet e reja të studentëve.
2. Mungesa e një baze materiale – laboratorike në nivelet e kërkuara nga koha.
3. Buxheti nuk administrohet duke u dispeçeruar deri ne njësitë bazë (Departamentet) ku paraqiten nevojat konkrete.

OPORTUNITETET

1. Karakteristikat e zonës dhe rajonit ku ushtrohet aktiviteti universitar.
2. Ekzistenca e resurseve njerëzore e materiale te afte për një pune te kualifikuar.
3. Specialistë të kualifikuar që mund bashkëpunojnë në shërbim të komunitetit dhe sipërmarrjes private.
4. Nevojat shumeplanesh të ekonomisë rajonale.
5. Interesat shumeplanesh të zonës dhe universitetit tonë.

KËRCËNIMET

1. Mungesa e mjeteve te duhura financiare për mbështetjen e punës kërkimore –shkencore në nivele bashkëkohore.
2. Buxheti nuk administrohet duke u shpërndarë deri në njësitë bazë (Departamentet) ku paraqiten nevojat konkrete.
3. Rrudhja e popullsisë në rajonin jugor si pasojë e emigracionit dhe largimit të të rinjve drejt qendrave të mëdha urbane.
4. Problematikat që kalon në përgjithësi aktualisht shoqëria jonë.

5. Konkurrenca e pabarabartë me homologët.
6. Hapja e Universiteteve dhe programeve të reja të studimit mbi bazën e gjykimeve jo profesionale dhe jashtë kritereve e parametrave të kërkuara duke ndikuar drejt për së drejti edhe në uljen e cilësisë së pranimeve në IAL.

